



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 07.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 18 pika C të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011-10 i miratuar 16.12.2008, dhe në nenin 6 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe paragrafit 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucioneve Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese Para universitarë në Republikën e Kosovës, Procedurat e zgjedhjes dhe të emërimit, përfundimit të Kontratës dhe emetimit të përkohshëm, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.03.2022, pas diskutimit lidhur me pikën 5 të rendit të ditës: Kërkesa për caktimin e anëtarëve të Komisionit rekrutues për Pozitat e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e DKA-së për formimin e komisionit të rekrutimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në shkollat e Komunës së Gjakovës, sipas Konkursit me nr. 01-111/01-2264 të datës 28.01.2022 .
2. Anëtarët e emëruar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës me propozimin e DKA-së janë :
 1. z. Zymber Berisha, Udhëheqës i Sektorit të Arsimit në Komunën e Gjakovës.
 2. znj. Valma Kamishi-Zeka, Drejtoreshë e Shkollës “ Këlmend Rizvanolli” në Gjakovë.
3. Anëtar i tretë i këtij Komisioni zgjidhet nga MASH-ti, ashtu siç është paraparë në Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë Komunale për Arsim .
 - Anëtarëve të Komisionit .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit



Znj. Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës